

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjermania mbështet Gjykatën Ndërkombëtare Penale pas sanksioneve nga Amerika - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/gjermania-mbeshtet-gjykatën-nderkombetare-penale-pas-sanksioneve-nga-amerika/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 14:26:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 14:25:31 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	412b41830b37349dc501bb368275d7d370d0981486827333d1a1243cb0fefe72
TEKSTI	cecbf724b106c2ab0fecfef37c1f78a1850871c049c2bfc5aac7252ed193a51f
PAMJA	b6ed93594920d9379280f184bfd31cab625d83af9edccb95eb4030f155d66827

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	acd7cd93fdb501f325dd261b462585f31a1b0c18949bfd983609ea3fd6ddcf7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	282274d0ff18f09ea4854e79728659ffe2d6cd028bfa2085cb95da6ce0a699bb
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/acd7cd93fdb501f325dd261b462585f31a1b0c18949bfd983609ea3fd6ddcf7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Edi Rama Lufta në Iran SHBA Kuvendi i Kosovës Rusia

BOTA

Gjermania mbështet Gjykatën Ndërkombëtare Penale pas sanksioneve nga Amerika

28 Shtator 2026 | 16:25

Gjermania ka premtuar mbështetje të fortë për Gjykatën Ndërkombëtare Penale (GJPN), në një kohë kur gjykata po përballet me presion dhe sanksione nga Shtetet e Bashkuara.

Ministri i Jashtëm gjerman, Johann Wadephul, deklaroi se rregullat ndërkombëtare janë të forta vetëm nëse shtetet janë të gatshme t'i mbrojnë ato.

"Sidomos në një kohë kur institucionet ndërkombëtare po vihen gjithnjë e më shumë në pikëpyetje, ne duhet t'i mbështesim ato së bashku me partnerët tanë globalë", tha Wadephul.

Ai theksoi se Gjermania do të kontribuojë që GJPN-ja të vijojë punën edhe nën presion. Wadephul pritej të vizitonte selinë e gjykatës në Hagë dhe të takojë me homologun e tij holandez, Tom Berendsen.

Sipas ministrit gjerman, GJPN-ja luan një rol të rëndësishëm në rastet kur sistemet kombëtare të drejtësisë nuk janë në gjendje ose nuk janë të gatshme të ndjekin penalisht krimet më të rënda.

Shtetet e Bashkuara nuk e njohin juridiksionin e GJPN-së dhe kanë vendosur sanksione ndaj gjykatës dhe disa prej përfaqësuesve të saj. Uashingtoni e ka akuzuar gjykatën edhe për veprimtari me motive politike.

E themeluar në vitin 2002, GJPN-ja heton dhe ndjek penalisht krime të rënda ndërkombëtare, përfshirë gjenocidin, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit.

Javën e kaluar, gjatë fjalimit në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, Presidenti amerikan Donald Trump u bëri thirrje vendeve anëtare të GJPN-së të tërhiqen nga gjykata.

Shiko në:

LAJMI I FUNDIT

16:02 Rasti i parë në Holandë, 2-vjeçarja i nënshtrohet eutanazisë

15:52 Një telefonatë në 999 zbuloi gjithçka, si u kapën 5 britanikët pranë bazës së RAF-it

15:30 Ekosistemi shqiptar i inovacionit prezantohet në Bits & Pretzels: 17 startupe, nga Shqipëria, Kosova dhe diaspora

SHPËRNDAJE
ARTIKULLINIER, policia shton kontrollet në akset rrugore, mbi 1000 gjoba

15:22 Shpërblim për zjarrfikësit e Tiranës, Veliaj çon projektvendimin në Këshillin Bashkiak

15:13 Irani mohon kategorikisht çdo lidhje me incidentit e rëndë në bazën amerikane në Britani

TESTIM

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA | EVROPA | LAJMI I FUNDIT

Një telefonatë në 999 zbuloi gjithçka, si u kapën 5 britanikët pranë bazës së RAF-it

Pesë shtetas britanikë nga Londra, të moshës 23 deri në 25 vjeç, janë personat e arrestuar pranë bazës ajrore RAF Fairford në Gloucestershire, në kuadër...

15:52 | 28/09/2026

BOTA

Irani ankesë në OKB për sanksionet amerikane në sektorin e aviacionit

Irani ka paraqitur një ankesë në OKB lidhur me sanksionet e SHBA-së kundër sektorit të tij të aviacionit, të cilat kanë detyruar anulimin e fluturimeve....

14:44 | 28/09/2026

BOTA

3 policë qëllohen për vdekje në Pakistanin veriperëndimor, plagosen 2 kalimtarë

Militantët vranë të paktën tre pjesëtarë të policisë rrugore në një pritë në veriperëndim të Pakistanit të hënën, tha Ministria e Brendshme. Incidenti ndodhi në...

14:41 | 28/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara

KOMPANIA

Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni

Follow Euronews on all platforms: